



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE UJORE

Nr. 445 prot.

Tiranë, më 9/3/2026

VENDIM

Nr.41, datë 9/3/2026

PËR

MIRATIMIN E KËRKESËS PËR AUTORIZIM PËR KRYERJE SHPIMI NËNTOKËSOR PËR MARRJE UJI (PUS-SHPIMI), TË “Z. MYQEREM SHEHAJ”, ME VENDNDODHJE: FSHATI KAPAJ, NJËSIA ADMINISTRATIVE SELIT, BASHKIA MALLAKASTËR

Në mbështetje të nenit 136, pika 3, të ligjit nr. 29/2024 “Për burimet ujore” i ndryshuar, si dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.319, datë 11.06.2025, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për përdorim burimi ujqor, dokumenteve shoqëruese, procedurës së shqyrtimit e vendimmarrjes, formateve të lejes, autorizimit, kushteve të posaçme dhe afateve të vlefshmërisë së tyre”, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore pasi mori në shqyrtim aplikimin me Nr. AN091220250047 të datës 09.12.2025,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për autorizim për kryerje shpimi nëntokësor për marrje uji (pus-shpimi), të “Z. Myqerem Shehaj”, me vendndodhje: Fshati Kapaj, Njësia Administrative Selit, Bashkia Mallakastër.
2. Treguesit paraprakë janë si më poshtë:

Koordinatat e vendndodhjes së shpimit (KRGJSH);

X= 485053; Y= 4490034; Z= 385 m.m.n.d

Qëllimi i përdorimit të ujit: Për qëllime familjare.

- Prurja e ujit të kërkuar: $Q = 0.1$ l/sek.
- Thellësia e pus-shpimit: 150 m.
- Diametri 1 (mm) 290 - Thellësia nga 0 m në 6 m
- Diametri 2 (mm) 220 - Thellësia nga 6 m në 150 m

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Anila SHEHU

